

TETOR 2025

BULETINI INFORMATIV

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

TAKIM NË KUADËR TË “DITËS NDËRKOMBËTARE TË TË MOSHUARVE”

Përfaqësues të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe specialistët nga Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë, zhvilluan një vizitë informuese pranë Qendrës Komunitare Multifunktionale, Bashkia Tiranë. Vizita u krye në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare të të Moshuarve”.



TAKIME NË KUADËR TË “TETORIT ROZË”

QSHNJP Vlorë në datën 20.10.2025 mori pjesë në konferencën e organizuar nga Këshilli i Qarkut Vlorë në kuadër të “Tetorit Rozë”. Tetori Rozë mbetet një muaj reflektimi dhe solidariteti dhe këtë vit, edhe QSHNJP Vlorë bashkoi zërin në rradhë me institucionet më të rëndësishme të Qarkut Vlorë për të përcjellë mesazhe ndërgjegjësuese në popullatë.



QSHNJP Tropojë në datën 29.10.2025 mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tropojë në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit. QSHNJP Tropojë i bashkohet kësaj kauze të rëndësishme për të rritur vëmendjen dhe mbështetjen për sensibilizim.



AKTIVITETE NGA QENDRAT E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

QSHNJP Mat, në kuadër të “Ditës Botërore të të Moshuarve” ishte pjesë e aktivitetit të zhvilluar nga Bashkia Mat, ku u zhvillua një sesion informues me qytetarët.



QSHNJP Mat zhvilloi në datën 02.10.2025, në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare Pa dhunë” një takim informues “Qendrës Ditore për Fëmijë” të organizatës “Motrat DOROTTE”.



QSHNJP Mat në datën 13.10.2025 zhvilloi një takim me nxënës dhe staf mësimor të shkollës 9 vjeçare “31 Korriku”, Burrel. Takimi u zhvillua në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare të Vajzave të Mitura”.



QSHNJP Elbasan, në kuadër të “Ditës Botërore të të Moshuarve” zhvilloi një aktivitet informues mbi Ndihmën Juridike Falas pranë Qendrës për të Moshuarit, Elbasan.



QSHNJP Elbasan, në kuadër të “Ditës Botërore Pa dhunë” zhvilloi një aktivitet informues “Street Law”.



QSHNJP Elbasan zhvilloi më datë 16.10.2025 një aktivitet pranë Bashkisë Prrenjas, në kuadër të nismës për zhvillimin e aktiviteteve informuese në bashkitë e vogla.



QSHNJP Elbasan, në datën 14.10.2025, në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare të vajzave të mitura” zhvilloi një aktivitet informues “Street Law”.



QSHNJP Vlorë, në datën 02.10.2025, në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare Pa Dhunë”, realizoi një takim me koordinatoren e rasteve të dhunës dhe psikologun e Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë.



QSHNJP Vlorë ishte pjesë e takimit me fokus drejtësinë restauruese për të rinjtë. Të pranishëm në takim ishin edhe bashkëorganizatorët si Drejtuesja e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, Ministria e Drejtësisë, si edhe Drejtuesja e Agjencisë Kombëtare të Rinisë.

QSHNJP Vlorë në bashkëpunim me Qendrën për Ndryshim dhe Zhvillim, me mbështetjen e Bashkisë Himarë, zhvilluan një takim informues mbi të drejtat e të rinjve dhe ndihmën juridike.





QSHNJP Vlorë në bashkëpunim me Qendrën për Ndryshim dhe Zhvillim, me mbështetjen e Bashkisë Selenicë, zhvilluan një takim informues mbi të drejtat e të rinjve dhe ndihmën juridike.



QSHNJP Lezhë në datën 02.10.2025 në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare Pa-dhunë” mori pjesë në aktivitetin mbi këtë fenomen, të organizuar nga Bashkia Lezhë.



QSHNJP Lezhë në datën 03.10.2025 zhvilloi një takim me përfaqësues të organizatës “QSHLI” dhe “CSSP”. Takimi kishte në fokus ndërmjetësimin dhe bashkëpunimin ndërinstytucional.




QSHNJP Lezhë në datën 15.10.2025 zhvilloi një takim me përfaqësuesit e Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të qytetit të Shkodrës.



QSHNJP Tiranë në datën 03.10.2025 në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare Pa dhunë” zhvilloi një aktivitet informues “Street Law”.

QSHNJP Tiranë në datën 06.10.2025 zhvilloi një takim me përfaqësues të organizatës jofitimprurëse CEDI.

QSHNJP Tiranë mori pjesë në tryezën e rrumbullakët me temë: “Diskriminimi i shumëfishtë: Fuqizimi i përgjigjes ndaj trafikimit të qenieve njerëzore tek individët LGBTI+ në Shqipëri”, të organizuar nga qendra “Streha”.




QSHNJP Përmet dhe QSHNJP Gjirokastrë në datën 03.10.2025 morën pjesë në takimin e zhvilluar në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare Pa-dhunë”, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastrë.

QSHNJP Përmet zhvilloi një aktivitet sensibilizues “Street Law” në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare të Vajzave të Mitura”.



QSHNJP Përmet në datën 12.10.2025 zhvilloi një takim me ndërmjetësen Loreta Mamani, ku u diskutua lidhur me procesin e referimit të rasteve për ndërmjetësim. Gjatë takimit u shkëmbyen informacione mbi mënyrat e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe rëndësinë e referimit të rasteve që mund të zgjidhen përmes dialogut dhe marrëveshjes.



QSHNJP Përmet në datën 22.10.2025 zhvilloi një takim informues me nxënësit e klasës së 9-të, në ambientet e shkollës “Meleq Gosnishti”, me qëllim njohjen e tyre me shërbimin e ndihmës juridike falas.



QSHNJP Përmet në datën 13.10.2025 zhvilloi intervistën informuese mbi ndihmën juridike falas.

Qshnjp Tropojë në datën 03.10.2025 në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare Pa dhunë” zhvilloi një takim përfaqësuesin e Zyrës së Avokatit të Popullit Kukës



QSHNJP Tropojë në datën 15.10.2025, në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare të Shkopit të Bardhë”, organizoi një aktivitet sensibilizues me anëtarë të Shoqatës së të Verbërve Tropojë.

QSHNJP Tropojë në datën 25.10.2025 mori pjesë në mbledhjen e Grupit Teknik Ndërsektorial të organizuar nga nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë Bashkisë Tropojë.

QSHNJP Tiranë në datën 30.10.2025 në ambientet e Gjimnazit “Sandër Prosi”, zhvilloi një aktivitet informues në kuadër të nismave për edukimin juridik të të rinjve.



QSHNJP Dibër në datën 27.10.2025 zhvilloi një takim informues me kryetarin e Shoqatës së Person me Aftësi të Kufizuara, Qarku Dibër.



QSHNJP Korçë zhvilloi në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare Pa dhunë” një takim informues me kordinatoren e dhunës pranë Bashkisë Korçë znj. Inelda Malka. Fokusi i takimit ishte rëndësia e bashkëpunimit institucional dhe rritja e aksesit në shërbimet e ndihmës juridike falas për viktimat e dhunës.

QSHNJP Korçë në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare të Vajzave të Mitura” zhvilloi një takim me studente të fakultetit të infermierisë, me qëllim sensibilizimin për të drejtat e vajzave të mitura dhe promovimin e ndihmës juridike falas.



QSHNJP Korçë në datën 15.10.2025, në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare të Shkopit të Bardhë”, mori pjesë në takimin e organizuar nga Shoqata e të Verbërve Korçë.

QSHNJP Korçë në datën 27.10.2025 ishte pjesë e mbledhjes së grupit ETN ku u diskutua mbi raste konkrete të përfitimit të ndihmës juridike.



QSHNJP Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Kujdesit Social realizuan një takim informues me përfitues të aftësisë së kufizuar.

QSHNJP Korçë në datën 14.10.2025 ishte e ftuar në emisionin “Cfarë duhet të dimë”, realizuar nga “Rtsh Korça”, dedikuar Ndhmës Juridike Falas.





QSHNJP Korçë në datën 27.10.2025 mori pjesë në konsultimin që mbështet angazhimin e Shqipërisë të bërë në “Forum Global për Refugjatët 2023” për të zbatuar procedura të decentralizuara të azilit, në përputhje me projektin EU4Migration dhe Strategjinë Kombëtare për Migracionin.



QSHNJP Gjirokastrë në bashkëpunim me Zyrën Përmbartimore Gjirokastrë dhe Degën Territoriale të Shërbimit të Provës Gjirokastrë, në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare të Vajzave të Mitura”, zhvilluan një takim me synim nxitjen e respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të vajzave të mitura në shoqërinë tonë.



QSHNJP Gjirokastrë në datën 28.10.2025 mori pjesë në aktivitetin për ndërgjegjësim dhe avokim mbi përfshirjen sociale.





QSHNJP Gjirokastrë në datën 29.10.2025 mori pjesë në konsultimin njëditor me autoritetet vendore mbi decentralizimin e procedurave të azilit në Shqipëri, i organizuar nga UNHCR në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme.



QSHNJP Gjirokastrë në datën 14.10.2025 zhvilloi një intervistë me median lokale “RTGJ” me temë: “Ndihma juridike e garantuar nga shteti, rastet e trajtuara, kategoritë përfituese”.

QSHNJP Gjirokastrë në datën 16.10.2025 zhvilloi një intervistë me median lokale “Euronews” me temë: “Interesi i qytetarëve mbi shërbimet ligjore falas, rastet e dhunës në familje, shërbimet e tjera më të kërkuara”.



QSHNJP Kukës në datën 20.10.2025 mori pjesë në takimin e organizuar nga shoqata "Together for life" me tematikë "Fuqizimi ekonomik dhe social i grave në Shqipëri".

QSHNJP Kukës në datën 20.10.2025 mori pjesë takimin me përfaqësuesit e Drejtorisë së Shërbimit Social pranë Bashkisë Has, ku u ritheksuan mundësitë e bashkëpunimit me Qendrën e Shërbimit të ndihmës Juridike Kukës për t'ju shërbyer qytetarëve mbi problematikat e tyre.



QSHNJP Durrës dhe QSHNJP Kavajë në datën 21.10.2025 morën pjesë në aktivitetin me tematikë “Mite dhe fakte për seksualitetin dhe aftësinë e kufizuar”, të organizuar nga fondacioni “Së bashku”.

QSHNJP Durrës dhe QSHNJP Kavajë në datën 10.10.2025 zhvilluan një aktivitet informues “Street Law”, në qytetin e Durrësit, në kuadër të Ditës Botërore të Shëndetit Mendor.



QSHNJP Pogradec në datën 30.10.2025 në bashkëpunim me Shërbimin e Provës, Pogradec organizoi në gjimnazin, " Muharrem Çollaku" një takim informues mbi dhunën dhe informimin ligjor.

QSHNJP Pogradec në datën 02.10.2025 në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare Pa-dhunë” organizoi një takim me përfaqësuesit e Shërbimit Psiko-Social, Bashkia Pogradec.



QSHNJP Pogradec në datën 15.10.2025 mori pjesë në takimin e organizuar nga Avokati i Popullit në përmbushje të mandatit të tij kushtetues dhe ligjor.

QSHNJP Fier me datë 03.10.2025 zhvilloi një aktivitet në kuadër të “Ditës Botërore të të Moshuarve” pranë Njesisë Administrative Dermenas, Bashkia Fier në kuadër të misionit për informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi të drejtat e tyre ligjore, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.



QSHNJP Fier në datën 22.10.2025 mori pjesë në një takim me përfaqësuese të OSBE-së ku u trajtuan disa problematika të ndyshme të cilat u përqendruan në çështjet që lidhen me aksesin në shërbime dhe ndikimin e digjitalizimit tek të moshuarit.

QSHNJP Shkodër në datën 02.10.2025 në kuadër të “Ditës Botërore të të Moshuarve” zhvilloi një takim ndërgjegjëses me përfaqësues të Shtëpisë për të Moshuar Shkodër.



QSHNJP Shkodër në datën 03.10.2025 ishte pjesë e ceremonisë së nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit për vijimin e funksionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje (MKR), e përditësuar në përputhje me ndryshimet më të fundit ligjore dhe institucionale.